



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Rev.nr.528/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar, Beshir Islami dhe Nenad Laziq, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit Y. D., nga P., të cilin e përfaqëson avokati Gazmend Sopa nga L., kundër të paditurës “L. K.” I. A. J.S.C, me seli në ..., L., të cilën e përfaqëson avokati Shkelzen Sopjani nga F.K., dhe L. F., zyrtare ligjore, për shkak të anulimit të njoftimit - vendimit, kthimit në punë dhe kompensimit të ardhurave personale, duke vendosur sipas revizionit të paditësit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.10784/2021 datë 20.09.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 4.12.2024, mori këtë,

### A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pathemeltë revizioni i paditësit Y. D. nga P., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.10784/2021 datë 20.09.2024.

### A r s y e t i m i

Me pjesën e I të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Lipjan C.nr.555/2020 dt.6.07.2021, aprovohet kërkesëpadia e paditësit si e bazuar dhe anulohet njoftimi – vendimi i të paditurës për mos vazhdimin e kontratës së punës të paditësit i dt. 4.03.2020, dhe detyrohet e paditura, që në afat prej 7 ditësh nga dorëzimi i aktgjykimit, paditësin ta kthejë në punë dhe detyra të punës në të cilat ka punuar “ agjent në ... ” tek e paditura, ose në punë dhe detyra

të punës që i përgjigjen përgatitjes së tij profesionale, me të njëjtën pagë mujore, si dhe brenda të njëjtit afat, për shkak të mos realizimit të ardhurave personale për periudhën kohore prej 4.04.2020 e deri 2.03.2021, t'ia shpërblejë paditësit dëmin material në emër të pagave neto të pa realizuara në shumë prej 4.688.45 euro, me kamatë ligjore prej 8% duke llogaritur nga dt.2.03.2021 si datë e hartimit të ekspertizës financiare e deri në pagesën definitive, si dhe në emër të kamatës për pagën neto në shumë prej 150.00 euro, në emër të trustit pensional në shumë prej 262.88 euro, në emër të tatimit në burim në dobi të ATK-së shumë prej 258.88 euro, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim dhe me pjesën e II të dispozitivit, detyrohet e paditura që paditësit t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 888.80 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit, me kërcënim të përmbarrimit me detyrim.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.10784/2021 të dt.20.09.2024, është aprovuar si e bazuar ankesa e të paditurës dhe ndryshohet pika I dhe II e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan C.nr.555/2020 dt.6.07.2021, ashtu që refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e sipër përmendur e paditësit Y. D., nga P.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, në afat ligjor paditësi ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që, aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, të sipër cekur, ta ndryshoi, ndërsa, aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan, C.nr.555/20 dt.6.07.2021, ta vërtetoi.

Përgjigje në revizion ka paraqitur e paditura, nëpërmjet të cilës kundërshton pretendimet e revizionit, me propozim që i njëjti të refuzohet si i pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në kuptim të dispozitës së nenit 215 të LPK dhe shkresave të lëndës si dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në revizion ka gjetur se:

Revizioni i paditësit është i pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësi më dt.13.05.2020, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurës, për shkak të anulimit të njoftimit – vendimit, kthimit në

punë dhe kompensimit të ardhurave personale, me të dhënat tjera si në petitumin e padisë, përkatësisht, si në precizimin e saj, të cilën pala e paditur e ka kontestuar. Pala paditëse, me të paditurën, ka themeluar marrëdhënie pune me kontrata në kohë të caktuar, për periudhën nga data 1.12.2018 deri më dt.4.04.2020, për vendin e punës “ agjent në ... “. Më datën 6.03.2020, paditësi, nga e paditura, ka pranuar njoftimin për mos ripërtëritjen e kontratës së punës, për shkak të skadimit të saj nga neni 67.par.1.3 dhe 2 i Ligjit të Punës. Paditësi në afat i është drejtuar të paditurës me ankesë më dt.3.03.2020, ndaj njoftimit të sipër përmendur, me kërkesë që të revokohet njoftimi. Nga vendimi i shkallës së parë të Inspektoratit të punës nr.rap.01-..., i dt.2.04.2020, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se ankesa e Shoqatës së Sindikale të punëdhënësit- paditurës, vendoset si e bazuar si dhe nga vendimi i shkallës së dytë të Inspektoratit të Punës nr..., dt.6.08.2020, aprovohet ankesa e parashtruar nga Shoqata Sindikale e punonjësve që të anulohen vendimet për mos vazhdimin e kontratës së punës për 23 punonjës. Nga parashtresa e dt.26.01.2021, ka vërtetuar se më dt.22.01.2021 tek e paditura kanë qenë të punësuar 770 punëtorë, gjatë periudhës 6 mujore duke filluar para dt.4.03.2020 numri i punëtorëve të cilëve iu është ndërprerë kontrata e punës me të paditurën është 5, ndërsa numri i punëtorëve me kontrata me afat të caktuar të cilëve nuk iu është vazhduar kontrata e punës me të paditurën është 23.

Nga vërtetimi i QPS-së në Lipjan nr.99 dt.26.01.2021, ka vërtetuar se paditësi nuk është shfrytëzues i skemës së asistencës sociale. Nga pasqyra e llogarisë bankare të paditësit për periudhën 1.01.2019 deri 25.01.2021, vërtetohet fakti se paditësit i është kredituar paga mujore nga e paditura përmes llogarisë bankare në BKT për periudhën prej 31.01.2019 – 31.03.2020. Nga pasqyra e llogarisë nga dt.1.01.2019 deri 22.01.2021, e lëshuar nga Trusti Pensional, vërtetohet se paditësit, nga e paditura, i janë paguar kontributet pensionale në Trust nga periudha 16.01.2018 deri 18.01.2021. Nga kontrata e punës për periudhë të caktuar dt.29.11.2018 vërtetohet se paditësi me të paditurën ka lidhur kontratë pune për periudhë të caktuar nga dt.1.12.2018 deri 3.04.2019. Nga amendamenti i kontratës së punës për periudhë të caktuar të dt.3.04.2019, vërtetohet se paditësit nga e paditura i vazhdohet kontrata e punës deri më dt.3.04.2020, ndërsa, paga bruto nga dt.4.04.2019 i caktohet në shumë prej 500-euro. Midis palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se paditësi tek e paditura ka punuar që nga data 1.12.2018 e deri më dt.4.04.2020, kur i është dorëzuar njoftimi me shkrim më dt.6.03.2020 për mos ripërtëritje të kontratës së punës, fakte që vërtetohen nga kontrata e punës dhe amendamenti i kontratës së punës në periudhë të caktuar. Nuk ishte kontestues fakti se ndaj paditësit nuk është zhvilluar asnjëherë procedurë disiplinore, apo

ndonjë procedurë e brendshme në lidhje me ndërprerjen e kontratës së punës. Sipas gjykatës së shkallës së parë, kontestuese ishte çështja e ligjshmërisë së njoftimit të paditurës për shkëputjen e kontratës së punës paditësit dhe se vendimi i tillë a është marrë në pajtim me dispozitat e Ligjit të Punës dhe se ky vendim a është i bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike. Me njoftimin – vendimin e të paditurës të dt.6.03.2020 paditësit i shkëputet kontrata e punës, për shkak të skadimit të kontratës aktuale të punësimit dhe mos ripërtëritjes së kontratës së punësimit në harmoni me nenin 67 par.1.3 dhe 2, nenin 71 të Ligjit të Punës dhe në harmoni me dispozitat e kontratës së punës. Gjykata e shkallës së parë, administroi edhe provat tjera, si ekspertizën e ekspertit financiar, leximin e vendimeve të Inspektoratit të Punës të shkallës së parë dhe të dytë, deklaratën e dëshmitarit B. L., parashtrësat, procesverbalet dhe shkresat tjera të lëndës, nga të cilat vërtetohet veç tjerash se, paditësi ishte pjesëmarrës i grevës së dt.19.21 dhe 21.08.2019, e organizuar nga Shoqata Sindikale e Pavarur e të paditurës. Paditësit, asnjëherë nuk i është dhënë performancë e paknaqshme për kryerjen e detyrave të punës për të cilat është caktuar dhe se e paditura, sipas marrëveshjes me SH.S.P-në, ( dt.23.08.2019) nuk do të merr asnjë masë kundër punëtorëve grevist etj. Ndërsa, lidhur me kërkesën për kompensimin e pagave, gjykata e shkallës së parë, bazuar në ekspertizën e ekspertit financiar A. I., ka gjetur se paditësi, për periudhën përkatëse, do të kishte realizuar të ardhura si në dispozitivin e aktgjykimit të saj.

Duke u nisur nga gjendja e këtillë faktike, gjykata e shkallës së parë, pas administrimit të provave, e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe në mbështetje të dispozitave të nenit 70, nenit 5.1 , nenit 78, nenit 79, të Ligjit të Punës, nenit 4 të LMD-së, nenit 13 të Ligjit për Grevat, etj, ka vendosur si në pjesën I dhe II të dispozitivit të aktgjykimit të saj.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurën ankimore, e ka aprovuar si të bazuar ankesën e të paditurës, ka vlerësuar se qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i papranueshëm, sepse nga gjendja faktike e vërtetuar, rezulton se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, andaj e ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ashtu që, e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar dhe ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të saj.

Në këtë gjendje të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se është i pranueshëm qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së dytë, kur ka vendosur për refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit, përkatësisht, aprovimin e ankesës së të paditurës dhe ndryshimin e aktgjykimit të

gjykatës së shkallës së parë. Aktgjykimi i goditur nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për të cilat Gjykata, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Aktgjykimi përmban arsye të mjaftueshme për faktet relevante, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Pretendimet e revizionit për shkelje thelbësore të dispozitave procedurale, nuk mund ta vënë në dyshim aktgjykimin e goditur dhe si të tilla nuk qëndrojnë. Po ashtu, aktgjykimi i lartë cekur, nuk është përfshirë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, siç pretendohet nga revizioni. Kjo për arsye se, sikundër ka gjetur edhe gjykata e shkallës së dytë, vendimi i të paditurës për mos ripërtëritjen e kontratës së punës është marrë në përputhje, veç tjerash, me dispozitat e nenit 10. par.1, par. 2, nenit 11, nenit 67 par.1, nënp.1.3, nenit 71. par. 2 të Ligjit të Punës, të cilat dispozita parashohin, përkatësisht, rregullojnë rastet dhe konditat ligjore për ndërprerjen, përkatësisht, mos ripërtëritjen e kontratës së punës, të cilat, në rastin konkret, ishin përmbushur.

Kështu, gjykata e shkallës së dytë, në rastin konkret civil, ka pasur parasysh faktin vendimtar - relevant, se marrëdhënia e punës ka qenë e krijuar në kohë të caktuar, prandaj, nga këtu, kontrata e punës, paditësit, nuk i është ripërtërirë, e njëjta ka skaduar sipas fuqisë ligjore (ex lege - neni 67 par.1, nënp.1.3 i Ligjit të Punës). Edhe sipas dispozitës ligjore të nenit 10 par.2, nënp.2.2 të Ligjit të Punës, parashihet se kontrata e punës lidhet edhe “ për një periudhë të caktuar”, sikundër edhe është rasti konkret juridiko-civil. Ndërkohë që, me dispozitën e nenit 71. par.2 të Ligjit të Punës, përcaktohet që “ Punëdhënësi mund të ndërpresë kontratën e punës për kohë të caktuar me njoftimin prej 30 ditësh kalendarike. Punëdhënësi i cili nuk ka për qëllim që të ripërtërijë kontratën me periudhë të caktuar duhet të informojë të punësuarin së paku 30 ditë para skadimit të kontratës. Dështimi për ta njoftuar nga punëdhënësi, do ti jap të drejtën të punësuarit për zgjatjen e 30 ditëve kalendarike shtesë me pagë të plotë”, ndaj, dispozitat e sipër përmendura, në rastin konkret, janë zbatuar drejtë, sikundër ka gjetur edhe gjykata e shkallës së dytë, prandaj, nga këtu, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se, nuk qëndrojnë as thëniet e revizionit për zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, ndërsa, aktgjykimi i goditur është i drejtë dhe i ligjshëm.

Kështu, në kontekstin e mësipërm, nuk qëndrojnë as thëniet e revizionit lidhur me pretendimin se në këtë rast, kemi të bëjmë me largimet kolektive nga puna, përkatësisht, nenin 76 të LP-së, gjë që nuk qëndron, për faktin sepse dispozita e nenit 76.1 të LP-së, që flet për largimet kolektive nga puna, ka të bëjë me dispozitën e nenit 70 par.1, nënp.1.1, të LP-së, që flet për ndërprerjen e kontratës së punës nga ana e punëdhënësit, kur ndërprerja e tillë arsyetohet për arsye

ekonomike, teknike ose organizative, gjë që, këtu nuk është rast, sepse në rastin konkret civil – juridik, kemi të bëjmë me ndërprerjen e kontratës së punës sipas fuqisë ligjore, përkatësisht, me dispozitën e nenit 67.1,1.3, të LP-së, e cila parasheh se kontrata e punës sipas fuqisë ligjore, veç tjerash, ndërpritet edhe “ me skadimin e kohëzgjatjes së kontratës”, sikundër edhe është rasti konkret civil –juridik.

Nga arsyet e lartcekura dhe në mbështetje të dispozitës së nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.528/2024 dt.4.12.2024

Kryetari i kolegjit,  
Mr.sc.Muhamet Rexha

